

V E N D I M
Nr. 296, datë 24.6.1999

**PËR NGRITJEN E NJË SISTEMI INFORMACIONI PËR SHPËRNDARJEN E BLOK-
NDIHMËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 7710, datë 15.5.1993 «Për ndihmën dhe përkujdesjen shoqërore» dhe të ligjit nr. 8439, datë 29.12.1998 «Për buxhetin e shtetit», me propozimin e Ministrisë së Punëve dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Krijimin në APNSHS të një sistemi të ri informacioni për shpërndarjen e ndihmës ekonomike, duke u bazuar në treguesit social-ekonomikë të mëposhtëm:

- a) Numri i popullsisë (konfirmuar nga zyrat e gjendjes civile);
- b) Numri i të punësuarve në sektorin shtetëror (konfirmuar nga zyrat e punësimit);
- c) Numri i të punësuarve në sektorin privat (konfirmuar nga zyrat e punësimit);
- d) Numri i personave me prona të paluajtshme (konfirmuar nga zyrat e regjistrimit të pasurive);
- e) Numri i pensionistëve (konfirmuar nga zyrat e sigurimeve shoqërore);
- ë) Numri i familjeve me tokë, numri i familjeve me pak tokë, numri i familjeve pa tokë (konfirmuar nga zyrat e kadastrës).

Formularët tip të këtyre treguesve i bashkëngjiten këtij vendimi.

2. Ky informacion merret nga pushteti vendor dhe shoqërohet me një relacion të hollësishëm për dinamikën e skemës ekonomike (numri i familjeve që kanë hyrë apo kanë dalë nga skema e ndihmës ekonomike, si dhe arsyet përkatëse) dhe dërgohet në drejtoritë rajonale të ndihmës dhe të shërbimeve sociale, brenda datës 1 të çdo fundkatërmujori (dhjetor, prill, gusht).

3. Drejtoritë rajonale të ndihmës dhe të shërbimeve sociale konfirmojnë saktësinë e të dhënave, nëpërmjet institucioneve përkatëse, dhe e paraqesin informacionin pranë APNSHS-së, brenda datës 10 të çdo fundkatërmujori (dhjetor, prill, gusht).

4. APNSSHS-ja e krahason këtë informacion me të dhënat e institucioneve qendrore, si me Institutin e Statistikës, me Institutin e Sigurimeve Shoqërore, me Shërbimin Kombëtar të Punësimit, me zyrën e regjistrimit të pasurive dhe, mbi këtë bazë llogarit shumën e bllok-ndihmës dhe shpërndarjen e saj. Kjo llogaritje, së bashku me informacionin përkatës, dërgohen në Drejtorinë e Buxhetit, në Ministrinë e Financave, brenda datës 25 të çdo fundkatërmujori (dhjetor, prill, gusht).

5. Sigurimi nga pushteti vendor i informacionit të saktë për treguesit e bllok-ndihmës është domosdoshmëri për llogaritjen dhe shpërndarjen e drejtë të saj.

6. APNSHS-ja, për vitin 1999, fillon grumbullimin dhe përpunimin e informacioneve në fillim të muajit korrik.

7. Ngarkohet Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale të nxjerrë udhëzimet përkatëse.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko